



Projekti është i financuar
nga Unioni Evropian



Instituti për të Drejtat e Njeriut

MANUAL për

LIRNË E SHPREHJES

ASPEKTE JURIDIKE



Projekt "Gazetaria investigative – gardian i demokracisë dhe i të drejtave të njeriut" implementuar nga Qendra për Administrim me Ndryshime dhe Instituti për të Drejtat e Njeriut, financuar nga Unioni Evropian dhe i kofinancuar nga Ambasada Britanike në Shkup.



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton opinionin e Unionit Evropian.



Ky publikim është i kofinancuar nga Ambasada Britanike. Opinionet dhe pikëpamjet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet apo qëndrimet e Ambasadës Britanike në Shkup.

MANUAL



**PËR LIRINË
E SHPREHJES
– aspekte juridike**



MANUAL PËR LIRINË E SHPREHJES-ASPEKTE JURIDIKE

Botues:

Shoqata e qytetarëve Instituti për të Drejtat e Njeriut
Shoqata për zhvillim Qendra për Administrim me Ndryshime

Për botuesin:

Margarita Caca Nikollovska

Autorë:

Sandra Buzlieva
Mila Isakovska

Redaktorë:

Maja Stojanoska
Miroslav Draganov

Përktheu:

Blerina Starova Zllatku

Lektura:

Tatjana Stojanovska

Disenji dhe shtypi:

Brigada dizajn

Tirazhi:

200 ekzemplarë (Tirazh falas/jokomercial)

CIP – Katalogizimi në publikim

Biblioteka Nationale dhe Universitare “Shën Klimenti i Ohrit”, Shkup
42.727(036)

BUZLIEVA, Sandra

Manual për lirinë e shprehjes: aspekte juridike / [autorë:
Sandra Buzlieva, Milla Isakovska]. – Shkup: #Shoqata e Qytetarëve
#Instituti për të Drejtat e Njeriut, 2016. – 12 f.; 21 cm

Fusnota të tekstit

ISBN 978-608-65230-7-7

1. Isakovska, Mila [autore]

a)Të drejtat e njeriut – Liria e shprehjes – Manualë

COBISS.MK-ID 101384458

Në formë elektronike publikimi është i aksesshëm në www.ihr.org.mk dhe në www.cup.org.mk



Ky publikim është përgaditur me ndihmën e Unionit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Unionit Evropian.

Manuali që është para jush, është një mjet i cili duhet t’ju shërbejë lexuesve, më saktësisht studentëve të gazetarisë, organizatave joqeveritare, si dhe gazetarëve profesionistë të njihen me standardet juridike të lirisë së shprehjes. Për më tepër, ky Manual duhet të përdoret si mekanizëm në kuadër të trajnimeve të studentëve të gazetarisë dhe gazetarëve të rinj në vendin tonë. Marrë në përgjithësi, iniciativa për hartimin e një Manuali të këtillë pikënisjen e ka në nevojën e sigurimit të një mjedisi të kualifikuar për gazetari investigative, që mbështetet mbi standardet e njohura universale.

Manuali përmban një vështrim konciz dhe përmbledhës të standardeve juridike të përcaktuara deri më tani dhe të praktikës gjyqësore në mbrojtje të lirisë së shprehjes, veçanërisht në nënqiellin evropian. Në të, janë sanksionuar normat kryesore ndërkombëtare dhe vendore juridike nga kjo fushë, duke i përkushtuar vëmendje të veçantë kriterëve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në parathënien e romanit “Ferma e kafshëve”, Xhorxh Orvel thotë: “Nëse liria do të thotë diçka, atëherë ajo e përcakton të drejtën që njerëzve tua thoni edhe atë që nuk duan ta dëgjojnë”. Ai në “Fermën e kafshëve” portretizon një botë në të cilën kufizimet gjithnjë në rritje të lirisë (përfshirë edhe atë të shprehjes), çojnë në gjendje të tiranisë.

Idetë, argumentet ose qëndrimet e reja, të cilat u bëjnë ballë mendimeve të huaja, tanimë të formuara, mund të jenë fyese për disa njerëz. Megjithatë, kostoja e të jetuarit në një shoqëri të lirë, domethënë se donjëherë do të ballafaqohemi edhe me qëndrime të këtilla të cilat na shqetësojnë. Midis profileve të ndryshme të njerëzve në shoqëri, ka edhe të atillë të cilët manifestojnë qëndrime fyese dhe të pahijshme. Por, ajo që është e rëndësishme është vet mundësia dhe hapësira që të nxiten qëndrimet e atilla, të përbuzen dhe ekspozohen në debat transparent. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konsideron se liria e shprehjes “nuk zbatohet vetëm tek informatat ose idetë që janë të mirëpritura ose që konsiderohen si të pranueshme apo ndaj të cilave pjesa më e madhe e shoqërisë është indiferente, por edhe ndaj atyre qëndrimeve të cilat fyejnë, shokojnë, ose i shqetësojnë autoritetet apo cilëndo qoftë pjesë të popullsisë” (Handysidev. UnitedKingdom¹).

Liria e shprehjes nënkupton njërin nga themelet bazë të shoqërisë demokratike dhe njërin nga kushtet themelore për progresin e saj, ndërkaq gazetarët luajnë rol eminent në shtetin, i cili udhëhiqet në bazë të sundimit të së drejtës.

¹ Handysidev. UnitedKingdom, no. 5493/72, 7 December 1976

Nga përkufizimet standarde, në lidhje me sundimin e së drejtës, veçohen dy elemente kyç:

1. restriksioni arbitrar i gëzimit të fuqisë përmes 2. harmonizimit të saj me ligje të specifikuar dhe mirë të përkufizuara.
2. Në mënyrë që një shoqëri demokratike të mund të lavdërohet si shoqëri në të cilën sundon e drejta, profesioni i gazetarit duhet të involvohet në kapacitetet e saj maksimale që ta përmbush rolin e vet të “gardianit të demokracisë”. Raportimi i rasteve të korrupsionit, mungesa e transparencës tek institucionet, qasja deri te informatat me karakter publik, i mbajnë në gjendje ngërçi ata të cilët me vetëdashje kanë bërë përpjekje ta kenë në dispozicion fuqinë, e cila u është besuar nga qytetarët. Gazetaria investigative kontribuon në drejtim të rritjes së transparencës për çështje me interes publik dhe debat më të madh në shoqëri.

Storje hipotetike

Gazetari X ka ngritur ankesë deri te Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke kërkuar nga Gjykata të vlerësojë nëse i është cenuar e drejta e lirisë së shprehjes. Gazetari X ka përpiluar një tekst në të cilin përmendet Kryeministri i shtetit Belavia në kontekst të rasteve të korrupsionit. Në kuadër të tekstit, gazetari thotë se dyshon se Kryeministri “vuan nga një sëmundje agresive psikopatike dhe ... për të mirën e publikut, këshillohet të konsultohet me specialistë”. Ai, në vazhdim, thotë se është evidente se Kryeministri i shfrytëzon 90% të mediave si portale të tij personale të cilat në vend që të raportojnë për raste të korrupsionit potencial dhe jotransparencës, ata fokusohen në revanshizëm me oponentët politikë.

Si rezultat i këtij teksti, Kryeministri ngre procedura civile në të cilat e padit për shpifje gazetarin X, si dhe shtëpinë gazetareske në të cilën ai punon, duke konsideruar se ky tekst është sulm mbi personalitetin dhe reputacionin e tij si politikan. Gjykatat vendase, në të gjitha instancat, janë të mendimit se ky tekst dhe fjalët e përdorura në të njëjtin e tejkalojnë kufirin e kritikës së pranueshme, “duke e përçmuar Kryeministrin në arenën politike dhe publike”. Gjykatat vendase konsiderojnë se në tekst theksohet se Kryeministri vuan nga një sëmundje mendore dhe me këtë i shkaktohet dëm serioz. Sipas kësaj, me Aktgjykimin gazetarit dhe shtëpisë së tij gazetareske u është përcaktuar të paguajnë 50.000 dollarë të Belavisë, si dëmshpërblim dhe obligim të publikohet falje në numrin e ardhshëm të gazetës.

Pyetje:

- A konsideroni se gjykatat kanë marrë vendim të drejtë me Aktgjykimin me të cilin gazetari shpallet fajtor për shpifje?
- A ka pasur të drejtë gazetari ta shkruaj atë tekst?
- Në cilin rast ka pasur dhe në cilin rast nuk do të kishte të drejtë ta publikojë këtë tekst?
- A ka gazetari të drejtë ankese?

Korniza ndërkombëtare e dokumenteve juridike dhe standardeve e mekanizmave

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: DUDNJ)², Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDCP)³ dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)⁴ janë në mesin e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare të cilat i garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, duke e përfshirë edhe të drejtën e shprehjes dhe lirinë e mendimit. Liria e mendimit dhe e drejta e shprehjes po ashtu garantohen me Deklaratën për të Drejtat e Njeriut të Bashkimit Evropian.

Sipas Kushtetutës, konventat e ratifikuara ndërkombëtare nga ana e vendit tonë janë pjesë e rregullimit të brendshëm juridik dhe të njëjtat nuk mund të ndryshohen me ligj. Kjo do të thotë se të njëjtat **zbatohen drejtpërsëdrejti**.

Në këtë Manual do të bëjmë një vështrim mbi një pjesë të dokumenteve, të ratifikuara nga RM:

Secili e ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike

Bazat e garancive të së drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes

DUDNJ⁵ dhe PNDCP⁶ janë dokumente të Kombeve të Bashkuara, të cilat e garantojnë të drejtën e mendimit dhe shprehjes. Garancitë përfshijnë:

- ▲ Të drejtën e çdo individ që të ketë mendim personal pa ndërhyrje,
- ▲ Të drejtën të kërkohen, të pranohen dhe të jepen informata përmes mediave pavarësisht kufijve.

² Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, <http://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

³ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, "Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.7 04/02/1971

⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf

⁵ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 19: "Secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë që të paraqes një mendim të caktuar pa kurrfarë ndërhyrje dhe të kërkohen, të pranohen dhe të jepen informata dhe ide përmes mediave pavarësisht kufijve."

⁶ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 19: "

1. Askush nuk mund të shqetësohet për shkak të mendimeve të veta.

2. Secili person e ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë, pavarësisht kufijve, e nënkupton lirinë e gjetjes, pranimit dhe përhapjes së ideve përmes të gjitha llojeve, në formë verbale, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose në çfarëdo qoftë mënyre sipas zgjedhjes së lirë.

3. Realizimi i lirisë të parashikuara në pikën 2 të këtij neni përfshin detyrime dhe përgjegjësi të posaçme. Rrjedhimisht me këtë, mund të ekspozohet në kufizime të caktuara të cilat duhet, megjithatë, të jenë përcaktuar me ligj, ndërsa janë të nevojshme për shkak:

a) të respektimit të të drejtave ose reputacionit të personave të tjerë;

b) të mbrojtjes së sigurisë së shtetit, të rendit publik, të shëndetit publik dhe të moralit."

- ▲ Të drejtën e individit, jo vetëm të përhap informata, por këtë ta bëjë në forma të ndryshme, duke e përfshirë formën verbale, të shkruar, të shtypur, artistike ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Sipas kësaj, rezultojnë disa karakteristika sa i përket lirisë së mendimit dhe shprehjes:

- ▲ Liria e mendimit personal është e drejtë absolute. Ajo nuk mund të kufizohet dhe praktikohet pa ndërhyrje, ajo është e drejtë absolute.
- ▲ Informatat të jepen dhe pranohen përmes mediave, me çka në mënyrë të tërthortë garantohet e drejta e medias.
- ▲ Mundësia që informatat të përhapen përmes mënyrave dhe formave të ndryshme.

Bazat e kufizimit të të drejtës së lirisë së shprehjes

Edhe DUDNJ dhe PNDPC parashikojnë kushte të përcaktuara në mënyrë strikte me të cilat mund të kufizohet liria e shprehjes.

Sublimuar nga të dy dokumentet, kufizimet e të drejtave të garantuara me DUDNJ⁷ parashikohen me qëllim që të:

- ▲ Sigurohet njohja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të të tjerëve;
- ▲ Mbrojtjes së moralit, rendit publik, shëndetit publik dhe mirëqenies së përgjithshme në një shoqëri demokratike; dhe
- ▲ Të njëjtat të parashikohen me ligj.

Këto dispozita nuk e nënkuptojnë të drejtën e shtetit, grupacionit ose individit të veprojnë ose të kryejnë ndonjë akt me qëllim të cenimit të të drejtave ose lirive apo të inkorpojnë kufizime më të mëdha nga ato të parashikuara. Gjithashtu, nuk njihet kurrfarë kufizimi ose reterimi nga liritë themelore të njeriut të cilat janë të njohura ose janë në fuqi në shtetin-palë nënshkruese të PNDPC, me arsyetim se PNDPC nuk i njeh ose i njeh në masë më të vogël.

⁷ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Neni 29:
“1. Secili ka detyrime ndaj bashkësisë në të cilën vetëm aty është i mundur zhvillimi i lirë dhe i plotë i personalitetit të tij.
2. Gjatë shfrytëzimit të të drejtave dhe lirive, çdo njeri do t'u nënshtrohet vetëm kufizimeve të atilla, siç janë përcaktuar me ligj, me një qëllim të vetëm të sigurohet njohja e detyrueshme dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe me qëllim që të kënaqen kërkesat përkatëse në lidhje me moralin, rendin publik dhe mirëqenien e përgjithshme në një shoqëri demokratike.
3. Këto të drejta dhe liri, në asnjë rast nuk mund të shfrytëzohen në atë mënyrë e cila është në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.”

Mekanizmat e mbrojtjes së të drejtës së shprehjes

Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, Këshilli për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara dhe Raportuesi Special për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes janë mekanizma mbrojtës në kuadër të Kombeve të Bashkuara.

Këto organe, qëndrimet dhe gjetjet e tyre për raste të caktuara i miratojnë në formë të raporteve ose rekomandimeve dhe të njëjtat nuk kanë efekt detyrues ndaj shteteve.

- 1. Komiteti për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara** (në tekstin në vijim: Komiteti) është një organ i përbërë nga ekspertë të pavarur. Shtetet anëtare të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike janë të obliguara që çdo 5 vjet pranë Komitetit të paraqesin raporte për masat që i kanë ndërmarrë me qëllim të implementimit dhe realizimit të të drejtave të specifikuar në Pakt. Komiteti vepron edhe ndaj **ankesave individuale**⁸. Ankesat shqyrtohen në sesione të mbyllura dhe vetëm vendimi përfundimtar që ka të bëjë me lëndën është dokument me karakter publik. **Pikëpamjet përfundimtare** të cilat i miraton Komiteti **nuk e kanë fuqinë ligjore të aktgjykimit të organit gjyqësor dhe nuk ekziston mekanizëm i veçantë për ekzekutimin e tyre.**
- 2. Këshilli për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara**⁹ (në tekstin në vijim: Këshilli) synon ta promovojë respektimin universal të të drejtave të njeriut dhe është kompetent për zbatimin e procesit të ri: “Pasqyra Periodike Universale”. Përmes këtij procesi shqyrtohet dosja e përgjithshme për respektimin e të drejtave të njeriut në një vend, duke e përfshirë edhe të drejtën e shprehjes me qëllim që të propozohen **rekomandime** përkatëse.
- 3. Raportuesi Special për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes** – i themeluar në vitin 1993. Raportuesi Special mund të adresojë kërkesa urgjente dhe shkresa me dedikim deri te qeveritë e vendeve anëtare të KB-së. Këto kërkesa janë në drejtim të sqarimit të të dhënave dhe të njëjtat nuk nënkuptojnë ose nuk paralajmërojnë gjykim ose akuzë kundër qeverisë të ndonjë shteti të caktuar.

⁸ Kjo e drejtë buron nga Protokollin Fakultativ i Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike.

⁹ Këshilli për të Drejtat e Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara është formuar me Rezolutën nr. 60/251, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2006.

2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Për arritje më të rëndësishme të Këshillit të Evropës, në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, konsiderohet Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në vitin 1950. Në **Nenin 10**¹⁰ të Konventës, parashikohet mbrojtja e lirisë së shprehjes.

Më shumë, për të drejtën e shprehjes në pjesën e Manualit: *Mbrojtja e lirisë së shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*.

Mekanizmat e mbrojtjes

Me Konventën u themelua Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Në tekstin në vijim: GJEDNJ), si mekanizëm për implementimin e saj.

Çdo vendim i Gjykatës, me përjashtim të mendimeve këshillëdhënëse, është i detyrueshëm për vendet anëtare.

Ankesë deri në GJEDNJ mund të paraqes çdo person fizik, grup qytetarësh ose organizatë qytetare, nëse janë të mendimit se ekziston cenim të disa nga të drejtat e garantuara me Konventë, përfshirë këtu edhe të drejtën e shprehjes.

Rasti iniciohet kundër shtetit.

Kërkesa¹¹ mund të paraqitet nëse janë absolvuar të gjitha mjetet juridike vendore, në afat prej gjashtë muaj pas vendimit përfundimtar.

Gjykata nuk vepron nëse kërkesat janë anonime, nëse tanimë ka marrë vendim ndaj kërkesës ose nëse është në kundërshtim me Konventën dhe protokollet e saj.

¹⁰ Neni 10: "1. Secili e ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë e përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimi, transmetimit të informatave ose ideve, pa ndërhyrje të autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve. Ky nen nuk i pengon shtetet, që institucionet e radios, filmit dhe televizionit t'ua imponojë regjimin e licencave të punës. 2. Realizimi i këtyre lirive, i cili përfshin obligime dhe përgjegjësi, mund të jetë nën formalitete të caktuara, kushte, kufizime dhe sanksione të parashikuara me ligj, të cilat në një shoqëri demokratike paraqesin masa të domosdoshme për sigurinë e shtetit, integritetin territorial dhe sigurinë publike, mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e trazirave dhe krimit, mbrojtjen e shëndetit ose moralit, reputacionin ose të drejtat e të tjerëve, për parandalimin dhe përhapjen e informatave konfidenciale ose ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e gjyqësorit."

¹¹ Formulari për paraqitjen e ankesës, si edhe të gjitha informatat e dobishme të procedurës, mund të gjenden në faqen zyrtare të GJEDNJ, në linkun në vijim: <http://www.echr.coe.int/Pages/home.aspx?p=applicants/mkd&c=>

Korniza juridike normative e lirisë së shprehjes në nivel nacional

Liria e shprehjes, si njëra nga të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit dhe mekanizmat për mbrojtjen e saj garantohen me Kushtetutën e RM¹² dhe në mënyrë plotësuese me disa ligje.

Bazat e garancisë së lirisë së shprehjes

Kushtetuta e RM Neni 16¹³ parashikon garanci të gjerë për të drejtën e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit. Përmes leximit të kujdesshëm të këtij neni, mund të vërehet se Kushtetuta garanton tre aspekte të lirisë së shprehjes publike të mendimit:

- ▲ Liria e fjalës dhe paraqitjes publike;
- ▲ Themelimi i lirë i institucioneve të informimit publikë;
- ▲ Qasja e lirë deri te informatat, pranimi dhe transmetimi i informatave.

Në mënyrë që të mbrohen të drejtat e personave të tretë, garantoheret e drejta e përgjigjes dhe e drejta e korigjimit në mjetet e informimit publikë. Me rëndësi për ushtrimin e veprimtarisë së gazetarit është garantimi i të drejtës së mbrojtjes së burimit të informacionit në mjetet e informimit publikë dhe ndalimi i censurës..

Krahas lirisë së shprehjes dhe mendimit, **Ligji për media¹⁴** e garanton edhe lirinë e shprehjes, publikimit, zgjedhjes dhe transmetimit të informatave. Gjithashtu, ky Ligj e rregullon **pluralizmin e mediave**, lirinë e qarkullimit të informatave dhe transparencën e mediave për mendime, bindje dhe përmbajtje të ndryshme, qasje deri te informatat me karakter publik, respektimin e personalitetit, privatësinë dhe dinjitetin e njeriut.

Është me rëndësi që Ligji të ofrojë garanci përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë së gazetarit, duke e siguruar të drejtën e gazetarit që ta shpallë mendimin dhe qëndrimin e tij, si dhe të refuzojë të kryej një urdhër, përkatësisht detyrë. Sa i përket

¹² Kushtetuta e RM, “Gazeta Zyrtare e RM” nr: 1/92, 4/92, 52/91, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 03/09 dhe 49/11.

¹³ Kushtetuta e RM, Neni 16: “Garantohet liria e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes së lirë të mendimit. Garantohet liria e të gjuhës, paraqitjes publike, informimit publik dhe themelimit të lirë të institucioneve për informim publik. Garantohet qasja e lirë deri te informatat, liria e pranimit dhe transmetimit të informatave. Garantohet e drejta e përgjigjes në mjetet e informimit publikë. Garantohet e drejta e korigjimit në mjetet e informimit publikë. Garantohet e drejta e mbrojtjes së burimit të informatës në mjetet e informimit publikë. Ndalohet Censura”

¹⁴ Ligji për media (“Gazeta Zyrtare e RM” nr.184/2013 dhe 13/2014).

mendimit dhe qëndrimit të shprehur, në përputhje me rregullat profesionale të profesionit të gazetarit, gazetarit nuk mund t'i ndërpritet kontrata e punës, nuk mund t'i zvogëlohet paga ose të ketë ndikim tjetër mbi të drejta të tjera nga marrëdhënia e punës.

Përveç asaj që i përcakton rregullat e themelimit dhe të punës së mediave, **Ligi për veprimtari radiodifuzive**¹⁵ e siguron edhe lirinë e shprehjes, të drejtën e korrigjimit dhe përgjigjes, qasjen deri te informatat dhe mbrojtjen e burimit të informatave.

Njëri nga ligjet më të rëndësishëm të lirisë së shprehjes është **Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje**¹⁶, me të cilin **dekriminalizohet** përgjegjësia e fyerjes së nderit dhe reputacionit dhe rregullohet përgjegjësia qytetare për dëmin e shkaktuar me kryerjen e këtyre veprave. Me miratimin e këtij Ligji tanimë nuk hapet procedurë penale, nuk ka përgjegjësi penale dhe as sanksion ndëshkues për kryerësit eventual. Pala e dëmtuar mund të ngre procedurë para gjykatës civile.

Për fyerje dhe shpifje të kryer përmes mjetit të informimit publik mund të përgjigjet autori i deklaratës, redaktori ose personi i cili e zëvendëson në mjetin për informim publik dhe personi juridik. Padiçesi, gjatë paraqitjes së padisë, është i lirë të vendos kundër cilit prej këtyre personave do të paraqes padi për përcaktimin e përgjegjësisë dhe për kompensimin e dëmit nga fyerja.

Për dallim nga ligjet e lartpërmendur, **Ligji për qasje deri te informatat me karakter publik**¹⁷ ka për qëllim të sigurojë transparencë gjatë punës së poseduesve të informatave¹⁸, si dhe t'u mundësojë personave fizikë dhe juridikë ta realizojnë të drejtën e qasjes së lirë deri te informatat me karakter publikë. Përrjashtimet, në mënyrë të saktë janë përcaktuar në Ligj.

¹⁵ Ligji për veprimtari radiodifuzive ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 100/2005, 19/2007, 103/2008, 152/2008, 6/2010, 97/2011, 13/2012 dhe 72/2013).

¹⁶ Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 143/2012.)

¹⁷ Ligji për qasje deri te informatat me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 13/2006, 86/2008 dhe 6/2010.)

¹⁸ Me posedues të informatave mendohet në: organet e pushtetit shtetëror dhe institucionet e organet e tjera të përcaktuara me ligj, organet e komunave, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave të Qytetit të Shkupit, institucionet dhe shërbimet publike, ndërmarrjet publike, personat juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë autorizime publike dhe veprimtari me interes publik.

Bazat e kufizimeve të lirisë së shprehjes

Liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes, mund të kufizohen vetëm në rastet e përcaktuara me Kushtetutë dhe të njëjtat janë përcaktuar në mënyrë strikte. Duhet të theksojmë se kufizimet kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes dhe jo me të drejtën e mendimit, e cila është e drejtë absolute, e cila realizohet pa ndërhyrje dhe e njëjta nuk mund të kufizohet.

Kufizimi i këtyre të drejtave është i mundshëm vetëm në gjendje lufte ose në gjendje të jashtëzakonshme, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës. Kufizimi nuk mund të jetë diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose sociale, pozitës pronësore ose shoqërore. Sido që të jetë, realizimi i kësaj lirie duhet të jetë në përputhje me respektimin dhe mbrojtjen e privatësisë së qytetarit, me jetën e tij personale dhe familjare, dinjitetin dhe reputacionin.

E drejta e mendimit është e drejtë absolute, që nuk është rast edhe me të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila e drejtë u nënshtrohet kufizimeve të caktuara

Njëkohësisht, në programet e radiodifuzerëve dhe në programet që emetohen në rrjetet e komunikimit publikë, nuk lejohet emetimi i programeve të cilët nxisin jotolerancë dhe urrejtje nacionale, racore, gjinore ose fetare.

Mekanizmat e mbrojtjes

Mbrojtjen e lirisë së shprehjes, qytetarët mund ta realizojnë para Gjykatës Kushtetuese, para gjykatave të rregullta dhe në mënyrë jashtëgjyqësore.

Gjykata Kushtetuese – Qytetarët, të cilët konsiderojnë se me ndonjë akt individual ose veprim u është cenuar ndonjë e drejtë ose liri, përfshirë këtu edhe të drejtën e mendimit dhe shprehjes, mund të paraqesin kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave deri te Gjykata Kushtetuese. Procedura e paraqitjes së kërkesës është rregulluar me Rregulloren e Gjykatës Kushtetuese. Në vendim, Gjykata Kushtetuese do ta përcaktojë edhe mënyrën e shmangies së pasojave nga zbatimi i aktit të veçantë ose veprimit me të cilat e drejta e mendimit dhe e shprehjes janë cenuar.

Mbrojtja gjyqësore – Kushtetuta e garanton të drejtën e mbrojtjes gjyqësore. Çdo qytetar, i cili konsideron se i është cenuar e drejta e mendimit dhe e shprehjes, mund të ngre procedurë para gjykatave vendore edhe atë: procedurë civile, penale, për kundërvajtje ose kontest administrativ. E drejta e ankesës kundër vendimeve gjyqësore të shkallës së parë është e garantuar.

Mbrojtja jashtëgjyqësore – Mbrojtja e lirive dhe të drejtave, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes garantohet dhe realizohet edhe përmes mekanizmave jashtëgjyqësor.

- **Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen dhe Lirinë e të Drejtave të Qytetarëve** është Komisioni i përhershëm i punës pranë Kuvendit të RM. Shqyrton çështje, mendime në lidhje me zbatimin e akteve normative dhe ofron propozime për miratimin e akteve normative për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve. Nuk ushtron funksion hulumtues dhe gjyqësor, ndërsa për punën e vet miraton konkluzione. Komisioni është i hapur për korrespondencë me qytetarët.

- **Avokati i Popullit** - organ i pavarur i cili i mbron të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve në rastet kur të njëjtat u cenohen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organe të tjera të cilat kanë autorizime publike. Nëse Avokati i Popullit konstaton shkelje të të drejtave, mund të miratojë rekomandim ose mendim për evitimin e shkeljes, të ngre iniciativë për hapjen e procedurës disiplinore dhe ngjashëm.

- **Komisioni për Qasje deri te Informatat me Karakter Publik** vendos për ankesat e qytetarëve ndaj një aktvendimi konkret me të cilin poseduesi i informatave ua ka refuzuar kërkesën për qasje deri te informatat kërkuesve të informatave. Kundër aktvendimit të Komisionit mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ deri te gjykata kompetente.

Gjuha e urrejtjes, fyerja dhe shpifja paraqesin tejkallim të lirisë së shprehjes dhe të kundërtën e saj

Kufizimi juridik dhe terminologjik i të drejtës së shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, shpifjes dhe fyerjes

Gjuha e urrejtjes

Nuk ekziston një përkufizim i pranuar për gjuhën e urrejtjes. Në Aneksin e Rekomandimit R (97) 20 të Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës për “gjuhën e urrejtjes” të miratuar më

datë 30 tetor të vitit 1997, me gjuhë të urrejtjes *“duhet të nënkuptohen të gjitha format e shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose arsyejnë urrejtje racore, ksenofobi, anti-semitizëm ose forma të tjera të urrejtjes të mbështetura në jotolerancë, duke përfshirë: jotolerancë të shprehur në formë të nacionalizimit agresiv, etnocentrizëm, diskriminim dhe armiqësi ndaj pakicave, migrantëve dhe personave me origjinë imigrante.”*¹⁹

KEDNJ në Nenin 17²⁰ thekson se asnjë dispozitë nga Konventa nuk mund të interpretohet si e drejtë që të ndërmerren aktivitete apo veprime me të cilat rrezikohet ndonjë e drejtë ose liri.

¹⁹ RecommendationR (97) 20, e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për gjuhën e urrejtjes:[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec\(97\)20_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec(97)20_en.pdf)

²⁰ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 17: *“Ndalohet keqpërdorimi i të drejtave. Asnjë dispozitë e Konventës nuk mund të interpretohet në atë mënyrë në të cilën, një shteti, grupi ose individ u është dhënë e drejta të ndërmarrin aktivitete ose veprime me të cilat rrezikohet ndonjë e drejtë ose liri të cilat janë të njohura me këtë Konventë, ose t'i kufizojnë këto të drejta dhe liri në masë më të madhe sesa nga ajo që është parashikuar me Konventë.”*

Sipas Manualit të ODIHR: *“HateCrimeLaws: A Practical Guide”*²¹, “gjuha vetvetiu, nuk do të paraqiste vepër penale pa ekzistimin e përmbajtjes së ndaluar, përkatësisht paragjykimit”. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Gündüz vs Turkey*²² si fjalë të urrejtjes i nënvizon “të gjitha format e shprehjes me të cilat përhapet, nxitet, promovohet ose arsyetohet urrejtja e bazuar në jotolerancë.”

Thënë shkurtimisht, gjuhën e urrejtjes mund ta kuptojmë si gjuhë e cila shpreh urrejtje, të orientuar ndaj një ose më shumë personave të cilët i përkasin një grupi i cili ka karakteristika të caktuara (për shembull: grup etnik, religjioz, komuniteti LGBT, persona me aftësi të kufizuara, tema konkrete historike etj.) dhe ka për qëllim ta fyej, përçmojë, përbuzë, të shpreh mllef ndaj personit ose grupit. Gjuha e urrejtjes e cenon dinjitetin dhe integritetin e personit, përkatësisht personave të cilëve u është adresuar. Se a do të interpretohet një shprehje si gjuhë e urrejtjes varet nga konteksti i shprehjes konkrete.

Fyerja dhe shpifja

Fyerja dhe shpifja kanë disa karakteristika të ngjashme me gjuhën e urrejtjes. Ligji për përgjegjësi qytetare, sa i përket fyerjes dhe shpifjes, e përcakton fyerjen dhe shpifjen si dhe përjashtimet nga përgjegjësia.

Për **fyerje** përgjigjet ai i cili me qëllim që të përçmojë, do ta cenojë nderin dhe reputacionin e një personi, përmes shprehjes ose publikimit të mendimit përçmues apo përmes mendimit përçmues të shprehur në mënyrë tjetër. Sipas këtij përkufizimi, fyerja është bërë atëherë kur ajo që është shprehur ka për qëllim të përçmojë.

Shpifja është vepër më e rëndë ndërsa ka përgjegjësi atëherë kur me dashje cenohet nderi dhe reputacioni i një personi, kur para personit të tretë shprehen ose transmetohen fakte të pavërteta të cilat e cenojnë nderin dhe reputacionin e tij, ndërkaq e ka ditur ose e ka pasur për detyrë ta dijë se janë të pavërteta. Elementet kryesore të shpifjes janë: 1) qëllimi për t'i shkaktuar dëm nderit dhe reputacionit të një personi dhe 2) personi i cili ka shpifur është dashur ta dijë ose duhej ta dinte se faktet e shprehura janë të pavërteta.

Dallimi, midis gjuhës së urrejtjes nga njëra anë dhe fyerjes e shpifjes nga ana tjetër, konsiston me atë se me gjuhën e urrejtjes personi nuk është fyer ose shpifur si individ i veçantë, por si anëtar i një komuniteti konkret, me të cilin ndan karakteristika të caktuara identitare, ndaj të cilave në të vërtetë është adresuar gjuha e urrejtjes. Gjuha e urrejtjes është vepër më e rëndë ndërkaq parashikohet trajtim juridiko-penal.

²¹ *“HateCrimeLaws: A Practical Guide”*, ODIHR, pg.25, <http://www.osce.org/odihr/36426?download=true>

²² *Gündüz vs Turkey* (Application no. 35071/97) Judgment 14 June 2004, par. 22, <https://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-61522>

Mbrojtja e lirisë së shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

- 1. Çdo njeri e ka drejtën e shprehjes së lirë. Kjo e drejtë e përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimit dhe transmetimit të informatave ose ideve, pa ndërhyrje të autoriteteve publike dhe pavarësisht kufijve. Ky Nen nuk i pengon shtetet që institucioneve të radios, filmit dhe televizionit tua imponojnë regjimin e licencave të punës.**
- 2. Realizimi i këtyre të drejtave, të cilat përfshijnë detyrime dhe përgjegjësi, mund të bëhet me formalitete, kushte, kufizime dhe sanksione të caktuara të parashikuara me ligj, të cilat në një shoqëri demokratike paraqesin masa të domosdoshme ndaj sigurisë së shtetit, integritetit territorial dhe sigurisë publike, mbrojtjes së rendit dhe parandalimit të trazirave dhe krimeve, mbrojtjes së shëndetit ose moralit, reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, parandalimit dhe përhapjes së informatave të besueshme ose ndaj ruajtjes së autoritetit dhe paanshmërisë së gjyqësorit.“**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e përfshin lirinë e shprehjes në Nenin 10, i cili ka dy paragrafë. Paragrafi i parë e përkufizon lirinë e mbrojtur. I dyti i specifikon rrethanat në të cilat shteti ka mundësi në mënyrë legjitime të ndërhyjë në gëzimin e të drejtës së shprehjes. Shtetet e kanë për detyrë ta justifikojnë çdo lloj të ndërhyrjes në lirinë e shprehjes.

Në paragrafin e parë ka tre komponentë të të drejtës së mbrojtur:

- ▲ Liria e mendimit personal;
- ▲ Liria e shkëmbimit të informatave dhe ideve;
- ▲ Liria e pranimit të informatave dhe ideve

Detyra e interpretimit të Konventës i është besuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin në vijim: Gjykata), përmes rasteve që i janë paraqitur në shqyrtim. Sipas Gjykatës, Neni 10 e përfshin edhe mbrojtjen e lirisë së gazetarisë (mediave) përmes mbrojtjes së burimeve prej të cilave gazetarët i pranojnë informatat. Gjithashtu, mbrohet edhe pluralizmi midis burimeve të informatave (mediave), që do të thotë se monopoli mbi mediat audio-vizuale konsiderohet se është në kundërshtim me Nenin 10. Gjuha, e cila promovon ideologji naziste, duke e mohuar Holokaustin, nxit urrejtje dhe diskriminim racor dhe është jashtë mbrojtjes së Neni 10. Nga ana tjetër, nxitja e dhunës në rrethana në të cilat ekziston mundësi reale që kjo të realizohet nuk është e mbrojtur si mënyrë e shprehjes.

Në *Sürek v. Turkey*(No. 3)²³, (rast i cili mbështetet mbi tekstin për lëvizjen liberale kombëtare të kurdëve), është miratuar konkluzioni se autori identifikohet me luftën e tyre dhe thërret ta kapin armën si mjet për arritjen e pavarësisë kombëtare të kurdëve. Së këtejmi, sipas Gjykatës, dënimi i autorit nga gjykatat vendore nuk konsiderohet se është në kundërshtim me Nenin 10.

Kufizime të lirisë së shprehjes

Gëzimi i kësaj të drejte bart me vete detyra dhe përgjegjësi

Ky interpretim më së shumti ka të bëjë me publikimin e qëndrimeve të cilat përmbajnë nxitje dhe thirrje për dhunë ndaj cilit do qoftë personi, grupi ose ndaj shtetit. Qëllimi është të parandalohet shfrytëzimi i mediave si mjet për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e dhunës. Nga ana tjetër, shtetet nuk mund të thirren në mbrojtjen e integritetit territorial, sigurinë nacionale, parandalimin e krimit ose trazirave dhe me këtë absolutisht ta kufizojnë publikun të pranojë informata të caktuara.

Gjykata vlerëson dhe vendos për çdo rast të veçantë se a ekziston ndërhyrje nga autoritetet, duke e vlerësuar ndikimin restriktiv ndaj gëzimit të lirisë së shprehjes. Më saktësisht, Gjykata i vlerëson masat konkrete të cilat i kanë zbatuar autoritetet nacionale për intervenim. Ndërhyrja e këtillë mund të jetë: dënim penal (dënim në para ose paraburgim), ndalim për publikimin e veprës, konfiskim i publikimeve, refuzimi i lëshimit të licencës për emetimin e programeve, ndalim për ushtrimin e profesionit të gazetarit, urdhër nga gjykata ose nga autoritete të tjera të zbulohen burimet gazetareske dhe/ose përcaktimi i dënimit në para nëse një gjë e këtillë nuk bëhet. Midis formave të ndryshme të ndërhyrjes, censura konsiderohet si më e rrezikshme, meqë e pengon transmetimin e informatave dhe ideve deri tek pjesa e publikut e cila me kënaqësi do të vinte deri te ato informata. Në rastin *Castells v. Spain*²⁴, aplikuesi (anëtar i opozitës parlamentare) është dënuar me burgim për përbuzjen e Parlamentit të Spanjës, për të cilin në një gazetë ka shkruar se është Parlament “kriminel” dhe se i fsheh kryerësit e veprave penale kundër njerëzve nga Baskia.“

Gjykata konsideron se mazhoranca parlamentare e cila e ka Qeverinë në çdo shtet duhet të jetë e përmbajtur ndaj ndërmarrjes së procedurës penale. Veçanërisht në rastet kur i kanë të aksesshme mjetet tjera për hapësirën mediatike në mënyrë që t’u përgjigjen sulmeve dhe kritikave të pa qëndrueshme të oponentëve të tyre. Në rastin *Okçuoglu v. Turkey*²⁵, (në të cilin aplikuesi është dënuar me burgim prej 1 viti e 8 muaj dhe me dënim në para për shkak të “propagandës separatiste”), Gjykata konsideron se ashpërsia e dënimit është joproporcionale si ndërhyrje në lirinë e tij të shprehjes.

²³ *Sürek v. Turkey*(No. 3), no. 24735/94, 8 July 1999

²⁴ *Castells v. Spain*,no. 11798/85, 23 April 1992

²⁵ Case of Baskayaand Okcoglu v. Turkey, no.23536/94 and 24408/94, 8 July 1999

Madje edhe kur dënimet penale konsistojnë me dënime relativisht të vogla në para, Gjykata konsideron se megjithatë ato mund ta luajnë rolin e censurës efektive, duke pasur një probabilitet të lartë në drejtim të dekurajimit që në të ardhmen të bëjnë kritikë të ngjashme. Në kontekst të debatit çdo herë të nevojshëm politik, kjo do t'i dekurajonte gazetarët që të kontribuojnë për një debat publik për çështje të cilat ndikojnë mbi jetën e komunitetit. Në mënyrë plotësuese, dënimet në para dhe shpenzimet gjyqësore mund të paraqesin ndërhyrje në të drejtën e lirisë së shprehjes, veçanërisht kur lartësia e tyre e arrin nivelin i cili e vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë financiare të personit, të cilit i është urdhëruar ta bëjë pagesën. Përcaktimi i dëmit në procedurë civile, i cili është përcaktuar për shkak të cenimit të dinjitetit ose nderit mund të nxisë ndërhyrje të konsiderueshme ndaj gëzimit të lirisë së shprehjes.

Tre kushtet për ndërhyrje legjitime në gëzimin e lirisë së shprehjes

Këto tre kushte duhet të përmbushen në mënyrë kumulative:

- ▲ ndërhyrja (“formaliteti”, “kushti”, “kufizimi” ose “dënimi”) të përcaktohet me ligj;
- ▲ ndërhyrja të synojë në mbrojtjen e një ose më shumë interesave ose vlerave: siguria nacionale; integriteti territorial; siguria publike; parandalimi i trazirave ose krimet; mbrojtja e shëndetit; morali; reputacioni ose të drejtat e personave të tjerë; parandalimi i publikimit të informatave konfidenciale; dhe ruajtja e reputacionit dhe pavarësisë së gjyqësorit;
- ▲ ndërhyrja të jetë e domosdoshme në shoqëritë demokratike

Sipas Gjykatës këto tre kritere duhet të interpretohen në kontekstin e tyre më të ngushtë. Interpretimi i ngushtë nënkupton se asnjë kriter tjetër nuk mund të zbatohet përveç atyre që janë theksuar në klauzolën e përjashtimeve. Të njëjtit duhet të nënkuptohen në mënyrë që shprehjet e përdorura të mos zgjerohen përtej domethënies së tyre të rëndomtë. Për çdo rast, ai i cili do të gjendej në ndonjë zonë të dyshimit gri, Gjykata specifikon standarde ligjore në të cilat liria e individit doemos duhet të balancohet në mënyrë më të volitshme përkundrejt pohimeve të autoriteteve shtetërore. Barra e provës se të tria kushtet janë përmbushur bie mbi shtetin e paditur.

Si “ndërhyrje e shtetit” doemos duhet të konsiderohet çdo formë e ndërhyrjes e cila bëhet nga cilido qoftë autoritet i cili ka fuqi dhe kompetenca publike ose është shërbim publik, siç është: gjyqësori, prokuroria, policia, çdo organ ligjzbatues, shërbimet i zbulimit dhe kundërzbulimit, këshillat e nivelit lokal ose qendror, njësi qeveritare, organe ushtarake të cilat marrin vendime, struktura profesionale publike etj.

Kushti i parë: “Gëzimi i këtyre lirive mund të jetë objekt i ... kufizimeve dhe dënimeve të përcaktuara me ligj” specifikon se çdo ndërhyrje në gëzimin e lirisë së shprehjes doemos duhet të ketë mbështetje në legjislacionin nacional. Sipas rregullit, kjo do të thotë ligji i shkruar dhe publik i miratuar nga Parlamenti. Veç kësaj, ligji duhet të jetë mjaft i qartë dhe i parashikueshëm, veçanërisht sa u përket pasojave.

Kushti i dytë: Secili nga këto kufizime të numëruara në mënyrë taksative duhet të argumentohen dhe justifikohen gjatë çdo zbatimi të tyre nga ana e shtetit (pushtetit) të involvuar.

Kushti i tretë: “Gëzimi i këtyre lirive...mund të jetë objekt i kufizimeve...të këtitilla... (të cilat)... janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike ...”

Në mënyrë që të merret ndonjë vendim sipas kushtit të tretë, gjykatat nacionale doemos duhet ta zbatojnë parimin e proporcionalitetit dhe të përgjigjen në pyetjen: “A ka qenë qëllimi proporcional me mjetet e përdorura që të arrihet ai qëllim?”. Këtu, “qëllimi” është një i vetëm ose disa nga vlerat e përcaktuara në kushtin e dytë, për mbrojtjen e të cilit shtetet kanë mund të ndërhyjnë në lirinë e shprehjes. Përkatësisht, “qëllimi” është interesi konkret të cilit i referohet shteti, siç është “siguria nacionale”, “rendi”, “moral”, “të drejtat e të tjerëve” etj. “Mjetet” e nënkuptojnë vet ndërhyrjen. “Mjetet” janë masa konkrete të cilat janë miratuar ose zbatuar ndaj një individi, i cili e gëzon të drejtën e tij të shprehjes. Për shembull, “mjetet” mund të jenë: dënimi penal për fyerje ose shpifje; urdhri që të paguhet dëmi në procedurë civile; parandalimi i shpalljes së publikimit; ndalimi për ushtrimin e profesionit të gazetarit; kontroll të hapësirave të medias; etj.

Vendimi për ekzistimin e proporcionalitetit mbështetet mbi parimet me të cilat udhëhiqet shoqëria demokratike. Më saktësisht, me qëllim që të dëshmohet se ndërhyrja ka qenë “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”, gjykatat vendore, si dhe Gjykata Evropiane, doemos duhet të sigurohen se me të vërtetë ka ekzistuar “nevojë e paprolongueshme shoqërore”.

Liria e shprehjes dhe siguria nacionale/ integriteti territorial dhe siguria publike

Sipas parimit të parë, i cili ka të bëjë me informatat në lidhje me sigurinë nacionale, konsiderohet meqë tanimë një herë janë publikuar publikisht, ato nuk mund të ndalohen, revokohen, ndërsa ata që i përhapin nuk mund të dënohen.

Parimi i dytë e përcakton ndalimin ndaj shteteve që t’i specifikojnë të gjitha informatat në fushën e sigurisë nacionale si të ndaluara ose të klasifikuara, si dhe ndalimin në mënyrë që apriori ta përcaktojnë kufizimin e qasjes deri te informatat e këtitilla. Disa informata të caktuara me të vërtetë mund të ndalohen, vetëm atëherë kur ka shkaqe serioze të besohet se përhapja e tyre në publikë do të shkaktojë kërcënim mbi sigurinë nacionale. Në mënyrë plotësuese, statusi i këtitillë konfidencial i informatave duhet të kufizohet në aspektin kohor, ndërsa nevoja për një status të këtitillë doemos duhet të kontrollohet periodikisht.

Interesimi i publikut që të njihet me informata të caktuara po ashtu duhet të merret parasysh kur disa informata, në lidhje me sigurinë nacionale, do të kategorizoheshin si konfidenciale. Prandaj, ligjet të cilat në formë absolute dhe të pakushtëzuar e ndalojnë përhapjen e të gjitha informatave nga fusha e sigurisë nacionale, duke e eliminuar kontrollin publik mbi aktivitetet e shërbimeve të zbulimit, do të paraqiste shkelje të Nenit 10, meqë politika e këtillë nuk është e “domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

Faktet kundrejt Gjykimit me vlerë

Një element i rëndësishëm në shumicën e rasteve të shpifjes është çështja e dëshmimit të deklaratave kontestuese. Në këtë aspekt Gjykata dallon dy kategori të deklaratave. Deklaratat faktike, në parim kërkojnë provën e vërtetësisë nga autori, ndërsa gjykimet me vlerë si shprehje të mendimit nuk mund të dëshmohen. Kërkesa e prodhimit të provës së gjykimit me vlerë e cenon lirinë e mendimit. Megjithatë, gjykimi me vlerë duhet të mbështetet mbi një bazë të mjaftueshme faktike. Nëse faktet tanimë janë të njohura për publikun, nevoja është më e vogël që të tregohet gjendja faktike. Në rastin e *Flux v. Moldova*²⁶, anëtarët e kastës së gazetarëve janë dënuar se e kanë akuzuar Partinë Komuniste për mitmarrje nga “importuesit e mëdhenj të naftës”. Edhe pse Gjykata ka pranuar se nuk është dëshmuar se importuesit me të vërtetë kanë dhënë ryshfet përmes organizimit të ahengjeve luksoze, e ka vlerësuar edhe faktin se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore midis ngjarjes dhe inicimit të procedurave për shpifje, e që paraqet pengesë për dëshmin e fakteve. Në fund, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 10 edhe përkrah asaj se në të vërtetë nuk janë dëshmuar të gjitha deklaratat faktike.

Bërja e dallimit midis fakteve dhe mendimeve dhe ndalimit të dëshmimit të së vërtetës është shumë e rëndësishme në sistemet juridike vendore, të cilat akoma kërkojnë prova për të vërtetën e veprës penale “fyerje”, që ka të bëjë me shprehjen e ideve dhe mendimeve. Kur një gazetar ose media ka qëllim legjitim, tema për të cilën shkruhet është me interes publik dhe janë bërë përpjekje esenciale që të verifikohen faktet, ata nuk do të konsiderohen për përgjegjës, madje edhe nëse faktet konkrete dëshmohen si të pavërteta.

Interesi publik kundrejt interesit privat

Faktor i rëndësishëm në mbrojtjen e lirisë së shprehjes është interesi publik tek deklaratat e shpifjes. Gjykata, gjatë publikimit të deklaratave të caktuara, interesin publik e ndërlihd me të drejtën e publikut që të pranojë informata për çështje me interes të përgjithshëm. Në rastet kur deklaratat janë bërë në kontekst të debatit publik, Gjykata mundëson mbrojtje plotësuese. Në rastin *Karhuvaara v. Finland*²⁷, gazetarët u dënuan për shkak se e kanë përmendur emrin e politikanës në një tekst të fokusuar mbi kontestet penale kundër bash-

²⁶ *Flux v. Moldova* no. 28702/03, 20 November 2007

²⁷ *Case of Karhuvaara and Ittalahti v. Finland*, no. 53678/00, 16 November 2004

këshortit të saj. Në këtë rast, Gjykata ka konstatuar se teksti nuk është çështje e interesit publik (sa i përket politikanës), por megjithatë, konsideron se publiku ka pasur të drejtë të informohet me aspektet private të politikanëve. Gjykata i ka ndërlidhur efektet e mundshme të qëllimeve votuese të qytetarëve me mundësinë e dënimit të bashkëshortit dhe me këtë ka konsideruar se ekziston një shkallë e caktuar e interesit publik.

Në rastet kur Gjykata duhet të kërkojë balancë midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës së reputacionit, ndërsa ka munguar interesi publik, zakonisht ka vendosur në favor të së drejtës së reputacionit. Gjykata konsideron se *doemos* duhet të bëhet dallim midis rasteve, në të cilat ekziston e drejta e publikut që të informohet dhe rasteve tek të cilat publikimi shërben vetëm për ta kënaqur kureshtjen të lexuesve të caktuar. Këtë parim, Gjykata e ka përdorur në *Leempoel v. Belgium*²⁸, me gjetjen se kufizimi i lirisë së shprehjes arsyetohet kur publikimi kontestues në mënyrë të drejtpërdrejtë e kritikon karakterin dhe personalitetin e gjyqtarit, pa dhënë kontribut në debatin me interes të përgjithshëm. Gjykata, zakonisht bën dallim midis nëpunësve publikë të involvuar në zbatimin e të drejtës, si prokurorë dhe gjyqtarë, si dhe të gjithë nëpunësit e tjerë publikë. Ata kanë mbrojtje më të madhe nga deklaratat të cilat i shpifin, për shkak të rolit të tyre në sistemin e jurisprudencës, me qëllim të promovimit të besimit tek të njëjtit. Megjithatë, nga ana tjetër, Gjykata shpeshherë paralajmëron për mundësinë që nëpunësit publikë ta keqpërdorin të drejtën e padisë për shpifje dhe efektin negativ të cilin mund ta ketë në debatin e lirë dhe transparentë për çështjet me interes publik. Në rastin e *Dyuldin v. Russia*²⁹, padi për shpifje është ngritur nga ana e disa anëtarëve të autoritetit rajonal pasi që aplikantët i kanë akuzuar autoritetet rajonale për abuzimin e fondeve dhe hakmarrje ndaj mediave të pavarura.

Në kuadër të parimeve kryesore, të cilat e mbrojnë privatësinë, Gjykata thotë: “pa marrë parasysh mizorinë e luftërave politike, *doemos* duhet të ekzistojë shkalla minimale e maturisë dhe sjellja përkatëse [...] “Nëse qëllimi kryesor ka qenë të fyhet personi, dënimi adekuat për sjelljen e këtillë nuk do të konsiderohej se e cenon të drejtën e lirisë së shprehjes”, *Sürek v. Turkey (No 1)*³⁰, *Lindon, Otczakovsky-LaurensandJuly v. France*³¹.

Njëri nga aktgjykimet më të reja, i cili elaboron më shumë aspekte të linjës së hollë midis komenteve të lejuara dhe të palejuara për jetën private të dikujt është *Couderc and Hachette Filipacchi Associés v. France*³². Në të vërtetë, Gjykata e shqyrtoi vlerën e interesit publik kundrejt jetës private të personave të involvuar në një tekst të revistës *Paris Match*. Përkatësisht, në vitin 2005, kësaj reviste, me aktgjykim të gjykatave franceze i është përcaktuar dënim prej 50.000 euro për dëmin e shkaktuar mbi të drejtat e Princit Alberti II i Monakos. Teksti kontestues përmbante intervistë të ish të dashurës së Princit, e cila ka pohuar se ai është babai i djalit të saj. Intervista i përshkruan rrethanat në të cilat ai e ka

²⁸ *Affaire Leempoel & S.A. ED. CINE REVUE c. Belgique, no 64772/01, 9 novembre 2006*

²⁹ *Case of Dyuldin and Kislov v. Russia, no. 25968/02, 31 July 2007*

³⁰ *Sürek v. Turkey (No 1), no.26682/95, 8 July 1999.*

³¹ *Lindon, Otczakovsky-Laurnes and July, no. 21279/02 and 36448/02, 22 October 2007.*

³² *Couderc and Hachette Filipacchi Associés v. France, no.40454/07, 10 November 2015.*

takuar, lidhjen e tyre intime, mënyrën në të cilën ka reaguar ai lidhur me shtatzëninë, si dhe raportin e tij me fëmijën pas lindjes së tij. Ajo, gjithashtu ka zbuluar se ka jetuar në banesën e tij në Paris dhe se ka pranuar mbështetje financiare si nënë e fëmijës së tij jashtë martese. Ky tekst është plotësuar me fotografi, në të cilat Princi është me fëmijën. Rrjedhimisht me këtë, Princi e ka paditur revistën dhe e ka fituar kontestin para gjykatave franceze. Ky rast është ankimuar në Strasburg nga ana e revistës.

Thënë shkurtimisht, kriteret të cilat duhet të kontrollohen janë: kontributi ndaj debatit për interesin publik, niveli i denigrimit të personit, tema e trajtuar në tekst, sjellja para-prake e personit të prekur, pasojat nga publikimi dhe nëse ka fotografi – rrethanat në të cilat janë realizuar ato. Gjykata, gjithashtu, shqyrton se në ç'mënyrë janë siguruar informacionet, vërtetësia e tyre, si dhe serioziteti i dënimit të imponuar ndaj gazetarëve. Në rastin e Albertit nga Monako, mes tjerash është shqyrtuar nëse atësia në këtë rast do të “kontribuoj në debatin me interes publik”.

Në disa raste Gjykata ka potencuar se interesi publik nuk mund të konsistojë me etjen për informata nga jeta publike e të tjerëve, duke e perceptuar këtë si senzacionalizëm ose voajerizëm (VonHannover v. Germany³³). Prandaj duhet të shqyrtohet konteksti në të cilin është shkruar teksti dhe vet qëllimi i tekstit. Në këtë rast Gjykata ka konsideruar se ndonëse teksti ka përmbajtur një numër të madh të detajeve të cilat kanë të bëjnë me jetën private të Princit, megjithatë i ngre çështjet me interes publik, veçanërisht për shkak të statusit të fëmijës si trashëgimtar potencial çështje e cila tanimë ka qenë temë e debatit publik.

³³ Von Hannover v. Germany, no. 40660/08 i 60641/08, 7 February 2012

Aktgjykim i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për rastin e Gazetarit X kundër shtetit Belavia

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, komentet e një gazetari janë të rëndësishme për stimulimin e debatit politik në një shoqëri demokratike. Gjykata, në këtë rast, e shqyrton balancin midis interesave të gazetarit që t'i transmetojë qëndrimet e tij kundrejt interesave të Kryeministrit që ta mbrojë reputacionin. Gjykata konsideron se komentet në tekst kanë nënkuptuar transmetimin e mendimeve të vlefshme dhe kanë pasur bazë faktike të mjaftueshme, pavarësisht se ato kanë qenë provokuese dhe fyese.

“Domosdoshmëria në shoqërinë demokratike” si kriter, kërkon nga Gjykata të përcaktojë nëse ndërhyrja ka korresponduar me “nevojën e paprolongueshme shoqërore”. Veçanërisht, Gjykata duhet të përcaktojë nëse shkaqet e cekura nga autoritetet shtetërore për ta justifikuar ndërhyrjen kanë qenë “relevante dhe të mjaftueshme” dhe se masa e ndërmarrë a ka qenë “proporcionale me qëllimin legjitim” (ChauvyandOthersv. France³⁴). Në këtë rast, Gjykata e rithekson se bëhet fjalë për gazetar, i cili është autor i tekstit në të cilin bëhet fjalë kinse për sjellje të paligjshme me korrupsion të politikanëve dhe figurave publike të nivelit të lartë, veçanërisht veprimet e Kryeministrit. Këto, padyshim janë pyetje të cilat janë me interes legjitim në një shoqëri demokratike dhe i përkasin rrethit të debatit politik. Meqë teksti ka të bëjë me Kryeministrin, si figurë politike i nënshtrohet kritikës për të cilën duhet të manifestohet më shumë tolerancë, për dallim nga kritika drejtuar një individi privat (Fedchenkov. Russia³⁵).

Megjithatë, nuk duhet të shpërfilllet edhe nevoja e mbrojtjes së reputacionit të politikanit, e cila mundësohet me Konventën (Lindon, Otczakovsky-LaurnesandJuly).

Por, madje edhe nëse pranojmë se shprehjet në tekst kanë qenë fyese dhe provokuese, megjithatë ato kanë qenë gjykime të vlefshme të bazuara mbi fakte, ngjarje dhe incidente konkrete, të cilat tanimë kanë qenë të njohura për publikun e gjerë. Nëse shprehjet fyese, si qëllim të vetëm e kanë fyerjen, atëherë shprehjet e këtilla nuk do të mbroheshin me Konventën (Skalkav. Poland³⁶) Gjykatat vendore nuk kanë arritur ta përcaktojnë “nevojën e paprolongueshme shoqërore” që reputacioni i Kryeministrit të vihet mbi të drejtën dhe lirinë e shprehjes dhe interesit të përgjithshëm publik. Prandaj, Gjykata konsideron se gjykatat vendore, përmes aktvendimeve të veta kanë vepruar në mënyrë joproporcionale dhe nuk kanë arritur ta dëshmojnë qëllimin legjitim për kufizimin e lirisë së shprehjes së gazetarit. Këtu është theksuar edhe dëmshpërblimi nga ana e gjykatave vendore, të cilin gazetari është dashur ta paguajë (Cihan Öztürkv. Turkey³⁷). Sipas kësaj që u tha më lartë, konstatohet se ka pasur shkelje të Nenit 10 të Konventës.

³⁴ ChauvyandOthersv. France, no. 64915/01, § 70, ECHR 2004-VI, 29 June 2004

³⁵ Fedchenkov. Russia, no. 33333/04, § 33, 11 February 2010

³⁶ Skalkav. Poland, no. 43425/98, § 34, 27 May 2003

³⁷ Cihan Öztürkv. Turkey, no. 17095/03, § 33, 9 June 2009

Të sublimojmë:

- ▲ Pa lirinë e shprehjes nuk ekziston sundimi i së drejtës
- ▲ E drejta e mendimit është absolute, ndërsa liria e shprehjes i nënshtrohet kufizimeve
- ▲ Ndërhyrja në lirinë e shprehjes doemos duhet të përcaktohet me ligj, me qëllime rreptësisht të kufizuara dhe të jetë reagim i domosdoshëm në një shoqëri demokratike
- ▲ Tek deklaratat faktike, në kuadër të ndonjë teksti, kërkohet dëshmia e vërtetësisë nga ana e autorit, ndërsa gjykimet e vlefshme si deklaratat të mendimeve nuk mund të dëshmohen
- ▲ E drejta e publikut të pranojë informata me qëllim të debatit publik gëzon mbrojtje më të madhe, por pranon kufizime kur në mënyrë të paarsyeshme cenohet ndonjë e drejtë e privatësisë së dikujt (kur nuk ekziston interes publik)
- ▲ Mekanizma mbrojtës funksional dhe efektiv, si gjyqësor, ashtu edhe jashtëgjyqësor janë jashtëzakonisht të rëndësishëm për gëzimin e mirëfilltë të lirisë së shprehjes
- ▲ Gjuha e urrejtjes nuk mund të arsyetohet përmes së drejtës së shprehjes së lirë

Bibliografia

Literatura:

1. Analiza juridike e konceptit të veprës penale të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes, Akademik Vllado Kambovski, Dr. Mirjana L Lazarova Trajkovska, mbështetur nga OSBE, shtator 2012.
2. Liria e shprehjes dhe gjuhës së urrejtjes, Dr. Elena Mihajlova, Dr. Jasna Baçotova, Mr. Tome Sheqerxhiev, mbështetur nga OSBE, dhjetor 2013.
3. E drejta e lirisë së mendimit dhe shprehjes dhe e drejta e tubimit paqësor dhe bashkimit, Donçe Boshkovski, Margarita Caca Nikollovska, Instituti për të Drejtat e Njeriut, dhjetor 2010.
4. Manual për shpifje dhe fyerje, botues: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, 2015.
5. Analiza e dispozitave të Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe fyerje, Vera Koco, Margarita Caca Nikollovska, botues: Instituti për të Drejtat e Njeriut.
6. HateCrimeLaws: A Practical Guide, OSCE/ODIHR, Warsaw, Poland, 2009.
7. The Camden Principles on Freedom of Expression and Equality, April 2009.
8. Media and Freedom of Expression in the Americas, published by International Association of Journalists, 2004.
9. Freedom of Expression Toolkit, A Guide for Students, published by UNESCO, 2013

Dokumente ndërkombëtare

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 1948, Kombet e Bashkuara.
2. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike 1966, Kombet e Bashkuara.
3. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Evropës.
4. Rekomandimi (97) 20, i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për gjuhën e urrejtjes”.

Ligje

1. Kushtetuta e RM (“Gazeta Zyrtare e RM nr.: 1/92, 4/92, 52/91, 31/98, 91/01, 84/03, 107/05, 03/09 dhe 49/11).
2. Ligji për Avokatin e Popullit (“Gazeta Zyrtare e RM nr. 60/2003 dhe 114/2009).

3. Ligji për media ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 184/2013 dhe 13/2014).
4. Ligji për veprimtari radiodifuzive ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 100/2005, 19/2007, 103/2008, 152/2008, 6/2010, 97/2011, 13/2012 dhe 72/2013).
5. Ligji për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 143/2012).
6. Ligji për qasje deri te informatat me karakter publik ("Gazeta Zyrtare e RM nr. 13/2006, 86/2008 dhe 6/2010.)

Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

1. Gündüz vs Turkey (Application no. 35071/97) Judgment 14 June 2004.
2. Handysidev. UnitedKingdom, no. 5493/72, 7 December 1976
3. Sürek v. Turkey(No. 3), no. 24735/94, 8 July 1999
4. Castells v. Spain, no. 11798/85, 23 April 1992
5. Caseof Baskayaand Okcoglu v. Turkey, no.23536/94 and 24408/94, 8 July 1999
6. Flux v. Moldova no. 28702/03, 20 November 2007
7. Karhuvaaraand Iltalehti v. Finland, no. 53678/00, 16 November 2004
8. AffaireLeempoel& S.A. ED. CINE REVUE c. Belgique, no 64772/01, 9 novembre 2006
9. Dyuldinand Kislov v. Russia, no. 25968/02, 31 July 2007
10. Sürek v. Turkey (No 1), no.26682/95, 8 July 1999
11. Lindon, Otczakovsky-LaurnesandJuly, no. 21279/02 and 36448/02, 22 October 2007
12. CoudercandHachetteFilipacchiAssociésv. France, no.40454/07, 10 November 2015
13. Von Hannover v. Germany, no.40660/08 i 60641/08, 7 February 2012
14. ChauvyandOthersv. France, no. 64915/01, § 70, ECHR 2004-VI, 29 June 2004
15. Fedchenkov. Russia, no. 33333/04, § 33, 11 February 2010
16. Skatkov. Poland, no. 43425/98, § 34, 27 May 2003
17. Cihan Öztürkv. Turkey, no. 17095/03, § 33, 9 June 2009

